



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 128 Prot.

Dt. 28.03.2018

Nr. 3130 Prot.

Tiranë, më 23.03.2018

URDHËR

Nr. 139, datë 23.03.2018

PËR

**HAPJEN E NJËSISË KRYESORE “KOLEGJI I STUDIMEVE TË LARTA
PROFESIONALE” NË KOLEGJIN UNIVERSITAR TË BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 30, pika 5 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit nr. 370, datë 26.04.2017 të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë”,

URDHËROJ:

- Hapjen e njësisë kryesore “Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale” në Kolegjin Universitar të Biznesit, me strukturën si më poshtë:
 - Departamenti i Studimeve të Larta Administrative;
 - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike.
- Veprimtaria akademike në njësinë kryesore “Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale” të Kolegjit Universitar të Biznesit, fillon në vitin akademik 2018-2019.
- Kolegji Universitar i Biznesit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Kolegjin Universitar të Biznesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTËR

Lindita Nikolla

